



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

---

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**th ë r r e t**

mbledhjen e katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më 10.05.2022 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 2.  
Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Propozimvendimi për shfuqizimin e pjesërishëm të Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2", me nr. 01-030/01-0088887/20, i dt. 11.06.2020;
2. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të basketbollit, hendbollit dhe Volejbollit, në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për organizimin e aktiviteteve "3x3 Prishtina Fiba Challenger";
4. Propozimvendimi për subvencionimin e nënave lehona, përfituese të skemës sociale (për të posalindurit e tyre);
5. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare kompanisë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", SHA në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me projektregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, nr. 01-030/01-0134831/18, e dt. 06.06.2018;
7. Propozimvendimi për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës "The Sunny Hill", SHPK;
9. Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing";

10. Propozimvendimi për themelimin e grupit punues për shqyrtimin e fushëveprimtarisë së NPL "Sport Marketing";
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-060/01-92273/22, më 27.04.2022

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina

